



20
25

RELACION ANALITIK

I ANKETËS
PËR MËSUESIT
E GJUHËS SHQIPE
NË DIASPORË

PËRMBAJTJA

Hyrje	3
Metodologjia e përdorur për anketim	4
Metodologjia e mbledhjes së të dhënave	7
Vendndodhja gjeografike e pjesëmarrësve në anketim	8
Mbledhja dhe analiza e të dhënave	9
Kufizimet e studimit	11
Profili demografik dhe profesional i të anketuarve	12
Përdorimi i teksteve mësimore të siguruara nga QBD-ja	14
Përdorimi i materialeve ndihmëse	17
Shpërndarja e teksteve dhe bashkëpunimi me QBD-në	21
Pjesëmarrja në trajnime dhe nevojat për zhvillim profesional të mësuesve	24
Sugjerimet e mësuesve për përmirësim të mëtejshëm	26
Si e shohin mësuesit punën e Qendrës së Botimeve për Diasporën	28
Vështrin cilësor: Zëri i mësuesve në diasporë	32
Përfundime	33

HYRJE

Ky relacion përmbledh gjetjet kryesore të anketës me mësuesit në diasporë, duke pasqyruar nevojat, sfidat dhe përvojat e tyre. Rezultatet synojnë të ndihmojnë në forcimin e mbështetjes dhe thellimin e bashkëpunimit me QBD-në.

Në zbatim të vendimit nr. 469, datë 26.07.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, i ndryshuar, vendimit nr. 443, datë 26.06.2019, “Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë”, i ndryshuar, urdhrit nr. 16, datë 08.05.2025, “Për ngritjen e grupit të punës për analizimin e rezultateve të anketës për mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë”, komisioni i ngritur me këtë qëllim hartoi këtë relacion në të cilin do të gjeni analizën e rezultateve të anketës së zhvilluar me mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë.

Ky relacion përmban gjetjet e anketës së ndërmarrë si pjesë e angazhimit të Qendrës së Botimeve për Diasporën për rritjen e transparencës, forcimin e komunikimit me mësuesit e gjuhës shqipe në diasporë dhe përmirësimin e mbështetjes institucionale ndaj tyre. Procesi i anketimit lidhet ngushtë me objektivat e përcaktuara në “Planin e integritetit të Qendrës së Botimeve për Diasporën”, miratuar me shkresën nr. 74/6 prot., datë 25.09.2023, veçanërisht në drejtim të evidentimit të situatës aktuale të mësimdhënies në diasporë, identifikimit të sfidave dhe nevojave reale të mësuesve në diasporë.

Anketa mbledh të dhëna të rëndësishme mbi profilin profesional dhe gjeografik të mësuesve, përvojën e tyre në mësimdhënie, përdorimin dhe vlerësimin e teksteve mësimore të QBD-së, sfidat që hasin në praktikën e përditshme, si dhe nivelin e komunikimit dhe përfshirjes në proceset mbështetëse të Qendrës.

Relacioni analizon përvojën e mësuesve si përfitues të mbështetjes institucionale dhe ofron një vlerësim të ndikimit të materialeve dhe trajnimeve të ofruara nga QBD-ja, në bazë të perceptimeve të tyre për dobishmërinë, përmbajtjen dhe shpërndarjen. Po ashtu, dokumenti përfshin edhe gjetje krahasuese të ndara sipas përvojës së mësuesve dhe vendndodhjes së tyre në diasporë, duke pasqyruar në mënyrë sa më të drejtë ndryshimet në nevoja dhe sfida. Për më tepër, përfundimet e relacionit pasurohen nga komentet e hapura dhe sugjerimet cilësore të dhëna nga vetë mësuesit në pyetjet e fundit të anketës.

METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR ANKETIM

Ky studim me anketim u zhvillua në prill 2025 dhe përfshiu mësues të gjuhës shqipe në diasporë, të kontaktuar përmes adresave elektronike nga databaza e QBD-së.

Ky studim me anketim është konceptuar në një fazë të vetme, të zhvilluar në muajin prill 2025, duke përfshirë mësuesit e gjuhës dhe kulturës shqiptare që ushtrojnë aktivitetin e tyre në diasporë, në shtete të ndryshme ku janë të pranishme komunitete shqiptare. Mësuesit janë kontaktuar përmes adresave të postës elektronike që Qendra e Botimeve për Diasporën ka në bazën e saj të të dhënave.


Qëllimi i këtij anketimi ishte të grumbulloheshin të dhëna të drejtpërdrejta mbi përdorimin e teksteve mësimore, materialeve ndihmëse, komunikimin me QBD-në, si dhe sfidat dhe nevojat me të cilat përballen mësuesit e gjuhës shqipe në diasporë në praktikën e tyre mësimore.

Në kuadër të këtij vlerësimi, anketa u dërgua në 745 adresa elektronike të mësuesve të gjuhës shqipe në diasporë, të përfshira në një databazë të hartuar në mënyrë informale nga Qendra e Botimeve për Diasporën, bazuar në komunikimet e vazhdueshme dhe bashkëpunimet e mëparshme me mësuesit. Nga këto, 545 adresa rezultuan të vlefshme dhe funksionale, ndërsa 158 adresa nuk ishin të sakta ose nuk ishin aktive. Për 42 raste të tjera, emaili nuk u dërgua dot për shkak të mbushjes së postës elektronike ose adresimit të emailit tonë në kategorinë “spam”.

Në total, nga kontaktet e realizuara, u morën 170 përgjigje të vlefshme, që përbëjnë rreth 31.2% të totalit të adresave të vlefshme (545 adresa në total). Këto përgjigje përbëjnë një bazë të konsiderueshme për analizë cilësore dhe orientuese.



Siç paraqitet në grafikun e mëposhtëm, **31.2% e mësuesve të kontaktuar dhe të ftuar për të marrë pjesë në anketë kanë kthyer përgjigje.**



Përgjigjet e pjesëmarrësve vijnë nga 14 shtete të ndryshme, përfshirë Greqinë, Italinë, Gjermaninë, Zvicrën, Austrinë, Suedinë, SHBA-në, Kanadanë, Kroacinë, Mbretërinë e Bashkuar, Francën, Turqinë, Norvegjinë dhe Serbinë. Ata përfaqësojnë një spektër të gjerë profilesh akademike dhe përvoja në mësimdhënie, çka i jep vlerë të shtuar pasqyrës së përftuar nga të dhënat. Përzgjedhja nuk është bërë përmes një modeli të mbyllur statistikor, por në mënyrë gjithëpërfshirëse, përmes shpërndarjes së pyetësorit në rrugë zyrtare dhe komunikimi të drejtpërdrejtë me mësuesit që veprojnë në kuadër të rrjetit të QBD-së.

Gjatë hartimit të pyetësorit, iu kushtua vëmendje përfshirjes së pyetjeve që mbulojnë fusha të rëndësishme, si: përvoja në mësimdhënie, përdorimi i materialeve të QBD-së, sfidat në proces, komunikimi institucional dhe përfshirja në trajnime.



Anketa u realizua në formë digjitale dhe u plotësua vullnetarisht nga mësuesit përgjatë një periudhe dyjavore. Të gjitha përgjigjet u përpunuan dhe janë përdorur për qëllime analitike dhe përmirësimin e mëtejshëm të punës.



ELEMENTI	PËRSHKRIMI
Mjeti i përdorur	Google Forms
Periudha e zhvillimit	Prill 2025
Numri i përgjithshëm i kontakteve	745 adresa elektronike nga databaza informale e QBD-së
Adresa të vlefshme dhe funksionale	545 adresa
Adresa të pavlefshme / jo funksionale	158 adresa (të pasakta ose të çaktivizuara)
Email-e që nuk u dërguan dot	42 raste (për shkak të mbushjes së kutisë postare ose klasifikimit në kategorinë “spam”)
Përgjigje të vlefshme të mbledhura	170 përgjigje
Vendet e përfaqësuara	14 shtete me prani të diasporës shqiptare
Lloji i pyetjeve	Të mbyllura, me alternativa, shkallë Likert dhe pyetje të hapura
Platforma e administrimit	Sistemet e brendshme të QBD-së
Formatet e analizës	Google Sheets, përpunim tematik dhe përmbledhje cilësore

METODOLOGJIA E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE

Procesi i mbledhjes së të dhënave u realizua përmes platformës Google Forms, duke garantuar një grumbullim të sigurt, të strukturuar dhe efikas të informacionit nga mësuesit në diasporë.

Procesi i mbledhjes së të dhënave për këtë anketim është konceptuar për të garantuar një grumbullim efikas, të sigurt dhe të standardizuar të informacionit nga mësuesit në diasporë. Anketa u ndërtua dhe u shpërnda përmes platformës digjitale *Google Forms*, që mundëson mbledhjen automatike të përgjigjeve dhe ruajtjen e tyre në mënyrë të organizuar dhe të aksesueshme për përpunim analitik.

Përdorimi i kësaj zgjidhjeje teknologjike ka mundësuar eliminimin e procesit manual dhe kalimin nga formati tradicional në atë digjital. Përmes lidhjes së sigurt në internet dhe kontrollit të strukturës së pyetësorit (pyetje të detyruara, degëzim logjik sipas përgjigjeve), është garantuar cilësia e të dhënave të mbledhura dhe është shmangur humbja e informacionit apo plotësimi i pasaktë.


Të dhënat janë ruajtur në kohë reale në sistemin e administrimit të QBD-së dhe janë eksportuar në formate standarde për analizë statistikore (*Google Forms*). Kjo metodë ka përshpejtuar procesin e përpunimit dhe ka mundësuar prodhimin e relacionit analitik në një kohë të shkurtër pas përfundimit të mbledhjes së të dhënave.

VENDNDODHJA GJEOGRAFIKE E PJESËMARRËSVE NË ANKETIM

Ky anketim u realizua me pjesëmarrjen e mësuesve të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare që veprojnë në diasporë, në shtete të ndryshme ku janë të pranishme komunitete shqiptare dhe ku funksionojnë struktura mësimore që ndjekin mësimin e gjuhës shqipe. Në total, në anketë morën pjesë mësues nga 14 shtete, me përfaqësim më të lartë nga Greqia (60 mësues) dhe Italia (52 mësues), të ndjekura nga Gjermania, Zvicra, SHBA, Kanada, Suedia, Austria, Kroacia dhe vende të tjera me përfaqësim më të kufizuar, si: Franca, Turqia, Mbretëria e Bashkuar, Norvegjia dhe Serbia.

Shpërndarja e pjesëmarrësve në këto shtete pasqyron përhapjen e gjerë të diasporës shqiptare, si dhe rrjetin e bashkëpunimit që QBD-ja ka krijuar me mësues dhe përfaqësi në këto vende. Kjo shtrirje gjeografike e anketimit garanton një panoramë të balancuar dhe realiste të situatës së mësimdhënies së gjuhës shqipe në kontekste të ndryshme.

» Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen e mësuesve pjesëmarrës sipas shteteve:



MBLEDHJA DHE ANALIZA E TË DHËNAVE

Pjesëmarrja ka qenë vullnetare, me njoftim paraprak mbi qëllimin e anketës.

Anketa me mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë është zhvilluar përmes një instrumenti me pyetje sasiore të strukturuar dhe të mbyllura, që synonin të mblidhnin të dhëna mbi përdorimin e materialeve mësimore të QBD-së, sfidat në mësimdhënie, komunikimin institucional dhe përfshirjen në trajnimet dhe aktivitetet mbështetëse.

Pyetësi është hartuar duke ruajtur balancën mes pyetjeve të karakterit informues dhe atyre të karakterit vlerësues. Për të lehtësuar shpërndarjen dhe përpunimin, anketa u ndërtua përmes platformës *Google Forms*, një mjet i thjeshtë për mbledhje të të dhënave në mënyrë digjitale dhe në kohë reale.

Për shkak të përhapjes gjeografike të mësuesve në 14 shtete të ndryshme, procesi i mbledhjes së të dhënave është realizuar nëpërmjet dërgimit të linkut të pyetësit përmes adresave të emailit që QBD-ja disponon në bazën e saj të të dhënave. Të gjithë të anketuarit janë informuar më parë për qëllimin e anketës dhe janë inkurajuar të plotësojnë formularin në mënyrë vullnetare.

Plotësimi i anketës është bërë në gjuhën shqipe, pasi pjesëmarrësit janë të gjithë mësues të gjuhës shqipe në diasporë. Pas mbylljes së mbledhjes së të dhënave, përgjigjet janë eksportuar automatikisht në *Google Sheets* dhe janë përpunuar në mënyrë statistikore për të nxjerrë përqindjet, tendencat dhe analizat tematike për secilin seksion të anketës.

Të dhënat e mbledhura janë analizuar nga ky grup pune, i cili ka hartuar këtë relacion me gjetjet kryesore dhe rekomandimet përkatëse.

Përdorimi i platformës Google Forms ka bërë të mundur monitorimin në kohë reale të të dhënave të mbledhura dhe ndjekjen e përmbushjes së objektivave të anketës sipas target-grupeve. Anketa është konceptuar duke përfshirë pyetje me shumë zgjedhje, pyetje në formatin e shkallës Likert (për vlerësime nga “shumë i/e kënaqur” deri te “fare i/e pakënaqur”), si dhe pyetje të hapura për komente dhe sugjerime cilësore.

Për garantimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së analizës, përgjigjet e pyetjeve të hapura janë rishikuar nga grupi i punës dhe janë kategorizuar sipas tematikave kryesore për të mundësuar përfshirjen e tyre në mënyrë të standardizuar në relacion.

Të dhënat e mbledhura janë kontrolluar dhe pastruar nga përsëritjet apo pasaktësitë para analizës statistikore. Përpunimi është realizuar përmes Google Sheets, duke ndërtuar tabela të përmbledhura dhe analiza krahasuese ndërmjet grupeve të mësuesve sipas vendit, përvojës në arsim dhe përdorimit të materialeve të QBD-së.

Rezultatet e paraqitura në këtë relacion janë bazuar në një analizë të dhënash të përmbledhura, përmes përqindjeve, krahasimeve dhe vlerësimeve tematike që ndihmojnë në formulimin e gjetjeve dhe rekomandimeve për përmirësim të mëtejshëm të punës së QBD-së me mësuesit në diasporë.

KUFIZIMET E STUDIMIT

Në interpretimin e rezultateve të këtij relacioni, duhen marrë parasysh disa kufizime që lidhen me mënyrën e mbledhjes së të dhënave dhe natyrën e grupit të synuar:

1. Përfaqësimi i pabarabartë gjeografik

Edhe pse në anketë morën pjesë mësues nga 14 shtete të ndryshme, numri i pjesëmarrësve ishte dukshëm më i lartë nga Greqia dhe Italia, ndërsa disa vende kishin përfaqësim minimal ose të vetëm. Kjo shpërndarje e pabalancuar ndikon në përgjithësimin e disa gjetjeve, veçanërisht kur flitet për sfidat ose praktikatat lokale në vende me përfaqësim më të kufizuar.

Vlen të theksohet se mësuesit e gjuhës shqipe që veprojnë në vende si Italia dhe Greqia, ku mësimdhënia organizohet kryesisht në bazë vullnetare, kanë treguar një nivel më të lartë interesimi dhe bashkëpunimi me institucionet e Republikës së Shqipërisë. Kjo ndodh sepse mbi 90% e tyre janë qytetarë të emigruar nga Shqipëria, çka i bën më të lidhur me institucionet e vendit të tyre të origjinës.

Si rezultat, numri i lartë i përgjigjeve nga mësuesit në këto dy vende pasqyron këtë angazhim të veçantë dhe dëshirën për të kontribuar në zhvillimin e mësimdhënies së gjuhës shqipe në diasporë. Kjo tregon se lidhjet kulturore dhe identitare ndikojnë pozitivisht në përfshirjen e tyre në proceset e anketimeve dhe bashkëpunimit institucional.

2. Pjesëmarrja vullnetare dhe jo e detyruar

Anketa u zhvillua në mënyrë vullnetare, çka do të thotë se pjesëmarrja mund të jetë ndikuar nga angazhimi personal, niveli i komunikimit me QBD-në ose motivimi për të kontribuar në përmirësimin e situatës. Kjo sjell mundësinë që disa mësues, të cilët nuk janë aktivë në rrjetin e QBD-së, të mos jenë përfshirë.

3. Mungesa e një modeli të kontrolluar statistikisht

Ndonëse janë mbledhur të dhëna nga një numër i lartë mësuesish (170 mësues), përzgjedhja e pjesëmarrësve nuk është bërë në mënyrë të rastësishme, por bazuar në listën e mësuesve në databazën tonë. Kjo do të thotë që rezultatet mund të pasqyrojnë vetëm grupin e përfshirë në anketë dhe nuk mund të përgjithësohen automatikisht për të gjithë diasporën.

4. Variacioni në interpretimin e pyetjeve të hapura

Teksa pyetjet e hapura kanë dhënë komente të vlefshme dhe sugjerime cilësore, interpretimi i tyre mund të jetë ndikuar nga subjektiviteti në analizë dhe standardizimi i mëvonshëm për qëllime përmbljedhjeje statistikore.

PROFILI DEMOGRAFIK DHE PROFESIONAL I TË ANKETUARVE

1. Shpërndarja sipas shteteve

Nga gjithsej 170 mësues që morën pjesë në anketë, shpërndarja gjeografike ishte si më poshtë:

- Greqi – 60 mësues
- Itali – 52 mësues
- Gjermani – 12 mësues
- Zvicër – 7 mësues
- Suedi – 7 mësues
- SHBA – 10 mësues
- Kanada – 4 mësues
- Kroaci – 4 mësues
- Austri – 4 mësues
- Mbretëria e Bashkuar (Londër) – 4 mësues
- Turqi – 2 mësues
- Norvegji – 2 mësues
- Francë – 1 mësues
- Serbi – 1 mësues



Kjo shpërndarje reflekton realitetin e diasporës shqiptare dhe rrjetin aktiv të bashkëpunimit që QBD-ja ka krijuar me mësuesit në vendet ku veprojnë shkollat e gjuhës shqipe.

2. Profili arsimor i të anketuarve

Në lidhje me formimin profesional të mësuesve:

- **43%** janë diplomuar në Gjuhë shqipe dhe Letërsi
- **19.4%** në Arsim fillor
- **37.6%** në fusha të tjera, përfshirë:
 - Shkenca Sociale,
 - Juridik,
 - Ekonomi,
 - Inxhinieri,
 - Mjekësi dhe fusha të tjera të ndryshme.

» Kjo përbërje tregon një shumëllojshmëri akademike në mesin e mësuesve të diasporës, ku një pjesë e mirë kanë ardhur nga profesione të tjera, por janë angazhuar në ruajtjen dhe promovimin e gjuhës shqipe.

3. Përvoja profesionale në mësimdhënie

Pjesëmarrësit në anketë kanë një shpërndarje të balancuar përsa i përket viteve të përvojës në mësimdhënien e gjuhës shqipe jashtë vendit. Rezultatet tregojnë:

- **38.2%** e mësuesve kanë **0–5 vjet përvojë**, që përfaqëson një brez më të ri në angazhimin për mësimin e shqipes;
- **29.4%** kanë **5–10 vjet përvojë**, që tregon një grup që ka ndërtuar eksperiencë të qëndrueshme në këtë fushë;
- **32.3%** kanë **mbi 10 vjet përvojë**, duke përfaqësuar mësues me angazhim afatgjatë dhe eksperiencë të thelluar në mësimdhënie në diasporë.

» Kjo përbërje tregon se QBD-ja bashkëpunon me një staf të larmishëm mësuesish, ku përfshihen si profesionistë të rinj, ashtu edhe mësues me një kontribut të gjatë në ruajtjen e gjuhës shqipe jashtë saj. Ky diversitet në përvojë ndihmon në pasurimin e praktikave mësimore dhe në identifikimin më të mirë të nevojave për mbështetje dhe trajnime.

4. Format e mësimdhënies dhe vendet e zhvillimit të mësimin

Mësuesit pjesëmarrës në anketë janë të angazhuar në forma të ndryshme të organizimit të mësimdhënies së gjuhës shqipe në diasporë. Bazuar në përgjigjet e tyre, mësimi zhvillohet në këto forma:

- **52.4%** japin mësim në kuadër të shkollave të organizuara nga komuniteti shqiptar ose shoqata kulturore në diasporë;
- **35.2%** punojnë në qendra kulturore ose institucione arsimore joformale, që ofrojnë mësim shqip një ose dy herë në javë;
- **12.4%** janë të përfshirë në iniciativa individuale ose private, përmes mësimin në grupe të vogla, kurse familjare ose platforma online.

» Kjo tregon një shumëllojshmëri modelesh organizative, që reflekton realitetin e diasporës dhe fleksibilitetin me të cilin mësuesit përshtatin mësimdhënien në varësi të kushteve specifike të vendit ku veprojnë.

» Në tabelën e dhënë më poshtë paraqitet shpërndarja e formave të mësimdhënies sipas shteteve, bazuar në përqindjet mesatare nga përgjigjet e mësuesve:

Shteti	Në komunitet	Në qendra kulturore /joformale	Iniciativa individuale/ online	Totali
Greqi	31	21	8	60
Itali	27	18	7	52
Gjermani	6	4	2	12
Zvicër	4	2	1	7
Suedi	4	2	1	7
SHBA	5	4	1	10
Kanada	2	1	1	4
Kroaci	2	1	1	4
Austri	2	1	1	4
Mbretëri e Bashkuar	2	1	1	4
Turqi	1	1	0	2
Norvegji	1	1	0	2
Francë	1	0	0	1
Serbi	1	0	0	1
Totali	89	57	24	170

Larmia në formatet e mësimdhënies dhe përvoja e ndryshme profesionale e mësuesve në diasporë tregojnë se mbështetja që ofron QBD-ja duhet të jetë e diferencuar dhe e përshtatur sipas nevojave specifike.

Mësuesit me përvojë të gjatë dhe ata që japin mësim në shkolla komunitare kanë nevojë për tekste të organizuara sipas klasave dhe trajnime të thelluara për menaxhimin e klasave heterogjene.

Ndërkohë, mësuesit më të rinj ose ata që veprojnë në mënyrë të pavarur, në mjedise joformale apo me orare të kufizuara, kërkojnë më shumë mbështetje në formën e materialeve të thjeshtuara, udhëzimeve metodologjike praktike dhe aksesit të shpejtë në burime digjitale.


Kjo shumëllojshmëri tregon qartë se mësuesit kanë nevoja të ndryshme, ndaj mbështetja duhet të jetë e larmishme dhe e përshtatur.

PËRDORIMI I TEKSTEVE MËSIMORE TË SIGURUARA NGA QBD-JA

Të dhënat e mbledhura përmes anketës tregojnë se **82.4%** e mësuesve të diasporës përdorin rregullisht tekstet mësimore të dërguara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, ndërsa **17.6%** e mësuesve në diasporë nuk i përdorin ato. Kjo përqindje e lartë tregon se tekstet e QBD-së kanë një përhapje të gjerë dhe përdoren si mjet bazë në mësimdhënien e gjuhës shqipe jashtë vendit.



Grafiku i mëposhtëm paraqet përqindjet e përdorimit të teksteve mësimore:



TEKSTET MË TË PËRDORURA

Mësuesit raportojnë se tekstet më të përdorura janë:

- “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare” – nivelet 1 dhe 2 (rreth 80% e përdoruesve);
- “Abetarja dhe fletoret e punës” – (rreth 15%);
- Tekste të tjera sipas nivelit apo lëndëve ndihmëse – (5%).

Përdorimi më i lartë i teksteve të nivelit 1 dhe 2 tregon se grupmoshat më të prekura janë fëmijët që sapo fillojnë mësimin e shqipes si gjuhë e dytë apo si gjuhë trashëgimie në familje dygjuhëshe.

PËRSHTATSHMËRIA E TEKSTEVE

Në pyetjen mbi përshtatshmërinë e teksteve për moshën dhe nivelin e nxënësve:

- **30.3%** i konsiderojnë shumë të përshtatshme;
- **56.3%** i konsiderojnë mjaftueshëm të përshtatshme;
- **13.5%** i vlerësojnë si pak ose aspak të përshtatshme.

Këto shifra tregojnë një nivel të kënaqshëm përdorimi, por gjithashtu edhe nevojën për përshtatje më të thelluara në funksion të grupmoshës dhe sfidave të mjedisit dygjuhësh.

PIKAT E FORTA TË TEKSTEVE SIPAS MËSUESVE

Mësuesit kanë evidentuar disa aspekte pozitive të teksteve:

- **62.3%** vlerësojnë përmbajtjen gjuhësore si të mirëformuluar dhe të përshtatshme për të nxitur mësimin bazë të gjuhës;
- **62.9%** theksojnë rëndësinë e ndërlidhjes së teksteve me kulturën shqiptare, duke i parë si mjet për edukimin kombëtar;
- **44.6%** vlerësojnë strukturën dhe ushtrimet praktike, sidomos në nivelet fillestare.

MANGËSITË E EVIDENTUARA NË TEKSTE

Megjithëse në përgjithësi tekstet vlerësohen pozitivisht, mësuesit kanë identifikuar disa mangësi:

- **28.6%** raportojnë mungesë të ushtrimeve praktike, sidomos për fëmijë që mësojnë përmes lojës dhe metodave interaktive;
- **23.5%** e konsiderojnë përmbajtjen jo të përshtatur plotësisht për kushtet e diasporës, sidomos për fëmijë me njohuri të kufizuara të shqipes;
- **16.2%** raportojnë gabime gjuhësore dhe gramatikore;
- Disa mësues vënë në dukje se tekstet janë të ngarkuara për mjediset ku mësimi zhvillohet vetëm 1–2 orë në javë.




Aspekti i vlerësuar	Rezultati nga anketa	Komente / Vëzhgime
Përdorimi i teksteve të QBD-së	82.4% e mësuesve i përdorin rregullisht	Tekstet përbëjnë bazën kryesore të procesit mësimor.
Teksti më i përdorur	“Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, nivelet 1–2 (80%)	I përshtatshëm për moshat e vogla dhe fillestare.
Përdorimi i Abetares/ Fletoreve të punës	15% e mësuesve	Përdorim më i ulët, por i vlerësuar nga klasat fillestare.
Përshtatshmëria për moshë dhe nivel	30.3% shumë të përshtatshme	Vetëm 13.5% i quajnë pak ose aspak të përshtatshme.
	56.3% mjaftueshëm të përshtatshme	
Pikat e forta	62.3% për përmbajtjen gjuhësore	Përmbajtje e pasur, ndihmojnë ruajtjen e identitetit kulturor.
	62.9% për lidhjen me kulturën shqiptare	
	44.6% për ushtrimet praktike	
Mangësitë e raportuara	28.6% mungesë ushtrimesh praktike	Nevojë për më shumë ushtrime dhe material të thjeshtuar.
	23.5% mungesë përshtatjeje për kushtet e diasporës	
	16.2% gabime gjuhësore	
Ata që nuk i përdorin tekstet	17.6% e mësuesve	Shkak: mosmarrja në kohë, mospërshtatje me nivelin, mungesë fleksibiliteti për grupe të përziera.

PËRDORIMI I MATERIALEVE NDIHMËSE

Materialet ndihmëse përbëjnë një shtesë të rëndësishme në procesin e mësimdhënies së gjuhës shqipe në diasporë. QBD-ja ka shpërndarë ndër vite një sërë botimesh, si: fjalorë dygjuhësh, libra me përralla dygjuhëshe dhe tregime të shkurtra, abetare ndihmëse, libra të ilustruar për fëmijë dhe mjete të tjera që synojnë të pasurojnë përvojën mësimore përtej teksteve bazë.

1. Shkalla e përdorimit të materialeve ndihmëse

Sipas të dhënave të mbledhura përmes anketës, 68.3% e mësuesve deklaruan se përdorin rregullisht ose herë pas here materialet ndihmëse të QBD-së, ndërsa 31.7% nuk i përdorin. Kjo tregon një shkallë të mirë integrimi të materialeve shtesë në praktikën mësimore, megjithatë, përqindja e mësuesve që nuk i përdorin mbetet domethënëse dhe meriton vëmendje.



2. Llojet më të përdorura të materialeve ndihmëse

Nga përgjigjet e hapura të pyetësorit rezulton se materialet më të preferuara janë: Fjalorët dygjuhësh (shqip–gjuhë e vendit pritës), që ndihmojnë nxënësit dygjuhësh në kuptimin e fjalorit bazë;

- Përrallat dygjuhëshe dhe “Tregimet e Moçme Shqiptare”, të ilustruara dhe të përkthyer, të cilat shihen si mjete të dobishme për nxitjen e dëgjimit dhe leximit;
- Materialet ndihmëse të përgatitura nga QBD-ja, që i ndihmojnë nxënësit të lidhen me traditën dhe historinë shqiptare përmes përmbajtjes së përshtatur sipas “Kurrikulës së Përbashkët për Mësimin e Gjuhës Shqipe dhe Kulturës Shqiptare në Diasporë e në Mërgatë”.

Mësuesit theksojnë se këto materiale përdoren sidomos në formë plotësuese ose gjatë aktiviteteve kreative, në grupe të vogla apo në fundjavë.

3. Dobishmëria dhe roli pedagogjik i materialeve

Mbi 70% e atyre që i përdorin i konsiderojnë materialet ndihmëse si të dobishme ose shumë të dobishme, sidomos për nxënësit fillestarë që kanë kontakt të kufizuar me gjuhën shqipe jashtë orëve të mësimin. Ato ndihmojnë në:

- Zgjerimin e fjalorit përmes ilustrimit dhe përkthimeve;
- Rritjen e interesit për lexim jashtë klasës;
- Forcimin e lidhjes emocionale me kulturën shqiptare.

4. Sfidat dhe pengesat në përdorim

Për mësuesit që nuk i përdorin materialet ndihmëse, arsyet më të përmendura janë:

- Mungesa e njohjes me përmbajtjen apo mosmarrja e materialeve fizike në kohë;
- Përshtatje e kufizuar me grupmoshat ose nivelet gjuhësore të nxënësve;
- Mungesa e strukturimit sipas klasave ose sipas temave të koordinuara me tekstet bazë;
- Një pjesë mësuesish sugjerojnë që materialet ndihmëse të përfshihen më qartë në një program të strukturuar didaktik ose të jenë të shoqëruara me udhëzime pedagogjike për përdorim sipas nivelit.

5. Rekomandime të përsëritura nga mësuesit

Nga komentet e hapura dolën disa sugjerime të përsëritura, si:

- Shtimi i materialeve të ndërveprueshme dhe digjitale (p.sh. libra audio, video, ushtrime online);
- Krijimi i paketave ndihmëse sipas grupmoshës dhe jo në mënyrë të përgjithshme;

Botimi i më shumë materialeve me tematika bashkëkohore, për ta bërë më të afërt me realitetin e nxënësve që rriten në një mjedis dygjuhësh e shumëkulturore.



Aspekti i analizuar	Rezultati / Përqindja	Komente kryesore
Përdorimi i materialeve ndihmëse	68.3% i përdorin	Përdorim i mirë, por me nevojë për rritje dhe njohje më të gjerë
	31.7% nuk i përdorin	
Materialet më të përdorura	Fjalorë dygjuhësh	Përdoren kryesisht për lexim të pavarur dhe aktivitete jashtë mësimit bazë
	Përrallat dygjuhëshe	
	Libra me përmbajtje kulturore	
Vlerësimi i dobishmërisë	70% i konsiderojnë të dobishme ose shumë të dobishme	Ndihmojnë në pasurimin e fjalorit dhe lidhjen me kulturën
Sfidat në përdorim	Mungesë informimi	Disa mësues nuk i kanë marrë ose i shohin të përgjithshme
	Mospërshtatje për nivelin	
	Mungesë strukturimi didaktik	
Rekomandime nga mësuesit	Më shumë përmbajtje digjitale	Rritje e aksesit, personalizim dhe përditësim i formateve
	Paketim sipas moshave	
	Udhëzime përdorimi	


SHPËRNDARJA E TEKSTEVE DHE BASHKËPUNIMI ME QBD-NË

Shpërndarja e teksteve dhe materialeve didaktike nga QBD-ja përbën një komponent kyç në mbështetjen institucionale të mësuesve të diasporës. Nëpërmjet kësaj pjese të anketës, synohet të kuptohet sa efektive është kjo mbështetje në praktikë dhe sa funksional është bashkëpunimi ndërmjet QBD-së dhe mësuesve në terren.

1. Koha e marrjes së teksteve nga mësuesit

Rreth **60% e mësuesve** deklaruan se i kanë marrë tekstet në kohë të përshtatshme, para fillimit të vitit mësimor ose në javët e para të tij. Ndërkohë, **40% e tyre** raportuan se i kanë marrë me vonesë, shpesh pas nisjes së mësimi, gjë që ka ndikuar negativisht në planifikimin dhe strukturimin e orëve.

» Grafiku më poshtë paraqet përgjigjet për kohën e shpërndarjes së teksteve:




Shkaqet më të përmendura për vonesat janë:

- vonesa në dorëzimin e kërkesave nga përfaqësitë diplomatike;
 - vonesa në procesin e shpërndarjes nga pala pritëse;
- komunikim jo i rregullt ndërmjet mësuesve dhe strukturave ndërmjetëse.

2. Vlerësimi i procedurës së shpërndarjes

Procedura e shpërndarjes vlerësohet pozitivisht nga shumica e mësuesve: **60%** e konsiderojnë “të pranueshme”, **14%** “shumë të mirë”, ndërsa rreth **26%** e cilësojnë “jo të kënaqshme”.



Nga komentet e hapura, vërehet se shumë mësues nuk janë të informuar për kohën dhe mënyrën e saktë të dërgimit të materialeve, pasi ky proces ndikohet nga ndërmjetësimi i ambasadave me shkollat shqipe në diasporë.

3. Komunikimi dhe bashkëpunimi me QBD-në


Kur mësuesit pyeten nëse ndihen të mbështetur nga QBD-ja:

- 45.5% e tyre përgjigjen “Po”;
- 30% përgjigjen “Pjesërisht”.
- 24.5% “Jo”;

Në total, **75.5% e mësuesve** kanë shprehur se ndihen të mbështetur plotësisht ose pjesërisht nga QBD-ja. Kjo përqindje e lartë dëshmon për një komunikim funksional dhe një prani institucionale të qëndrueshme, edhe pse mbetet hapësirë për thellim të mëtejshëm të bashkëpunimit.



Grafiku më poshtë paraqet nivelin e mbështetjes që mësuesit deklarojnë se kanë marrë nga Qendra.



4. Sfidat e përmendura dhe sugjerime për përmirësim

Në komentet e tyre, mësuesit përmendin disa sfida dhe rekomandime të përsëritura:

- Nevoja për një mekanizëm të qartë dhe të standardizuar për porositjen dhe shpërndarjen e teksteve;
- Rritje të komunikimit të drejtpërdrejtë me QBD-në, përmes një kontakti fiks ose platforme digjitale;
- Krijimi i një portali të unifikuar ku mësuesit mund të deklarojnë nevojat dhe të ndjekin statusin e dërgesave;
- Bashkëpunim më i ngushtë me ambasadat dhe konsullatat shqiptare për të shmangur ndërprerje logjistike.



Shpërndarja e teksteve dhe bashkëpunimi me QBD-në:

Aspekti i vlerësuar	Përgjigje pozitive / të pjesshme	Përgjigje negative	Vërejtje kryesore
Koha e marrjes së teksteve	60% i marrin në kohë	40% raportuan vonesa	Vonesa nga përfaqësitë ose logjistika vendore
Vlerësimi i procedurës së	50% e konsiderojnë të pranueshme	26% jo të kënaqur	Komunikim jo i qartë për shpërndarjen
Ndihen të mbështetur nga QBD-ja	45.4% ndihen të mbështetur	24.5% nuk ndihen të mbështetur	Kërkohet kontakt i drejtpërdrejtë dhe ndjekje më e afërt me mësuesit
	30% ndihen pjesërisht të mbështetur		

PJESËMARRJA NË TRAJNIME DHE NEVOJAT PËR ZHVILLIM PROFESIONAL TË MËSUESVE

Një ndër faktorët kyç për rritjen e cilësisë së mësimdhënies së gjuhës shqipe në diasporë është mbështetja e vazhdueshme profesionale e mësuesve. Për këtë arsye, anketa i ka kushtuar një seksion të veçantë përvojës së tyre me trajnimet e ofruara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, si dhe pritshmërive për zhvillim të mëtejshëm profesional.

1. Pjesëmarrja në trajnime të organizuara nga QBD-ja:

Sipas të dhënave të mbledhura, vetëm 36.5% e mësuesve kanë marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga QBD-ja, ndërsa 63.5% nuk kanë marrë pjesë. Kjo përqindje e ulët pjesëmarrjeje tregon se:

- QBD-ja duhet të rrisë shtrirjen, promovimin dhe aksesin e trajnimeve;
- Një pjesë e madhe e mësuesve nuk kanë qenë të informuar në kohë ose nuk kanë mundur të marrin pjesë për shkak të orareve, vendeve të zhvillimit ose mjeteve teknike.

2. Vlerësimi i dobisë së trajnimeve

Nga mësuesit që kanë marrë pjesë në trajnime:

- **51.7%** i vlerësojnë si të dobishme;
- **44.8%** si mjaftueshmërisht të dobishme;
- **Vetëm 3.5%** si pak ose aspak të dobishme.

Ky rezultat tregon se për ata që marrin pjesë, trajnimet kanë një ndikim pozitiv. Përmbajtjet më të vlerësuara janë:

- Metodatat didaktike për mësimin e shqipes si gjuhë e dytë;
- Zhvillimi i materialeve ndihmëse dhe ndërvepruese;

Kombinimi i gjuhës me elemente të kulturës shqiptare në klasë.

3. Temat e kërkuara për trajnime të ardhshme

Në pyetjen për temat që mësuesit do të dëshironin të trajtoheshin në të ardhmen, më të përmendurat ishin:

- Përdorimi i metodave interaktive dhe digjitale në mësim;
- Menaxhimi i klasave të përziera sipas moshës dhe nivelit gjuhësor;
- Hartimi i planeve mësimore fleksibël për kushte me orar të reduktuar (1–2 herë në javë);
- Trajnime për ndërtimin e materialeve vetjake dhe punë me projekte;
- Si të integrohet kultura shqiptare përmes artit, muzikës dhe literaturës për fëmijë.

Mësuesit theksojnë gjithashtu dëshirën për platforma të qëndrueshme trajnimi online, me mundësi për akses sipas kohës së tyre të lirë, si dhe certifikim për pjesëmarrjen.



Kjo pjesë e anketës tregon qartë se mësuesit e diasporës kanë dëshirë dhe nevojë reale për zhvillim profesional të vazhdueshëm, por që për momentin nuk është shfrytëzuar plotësisht për shkak të aksesit të kufizuar ose mungesës së informacionit. QBD-ja duhet të forcojë ndjeshëm këtë linjë mbështetjeje, si në aspektin logjistik, ashtu edhe në përmbajtje të përshtatura për realitetin e diasporës.

KATEGORIA	Përqindja	Shënime
Pjesëmarrja në trajnimet e QBD-së		
Mësues që kanë marrë pjesë	36,5%	Pjesëmarrja e ulët, nevojë për rritje
Mësues që nuk kanë marrë pjesë	63,5%	Kufizime në akses dhe informim
Vlerësimi i dobisë së trajnimeve		Bazuar në përgjigjet e pjesëmarrësve
Të dobishme	51,7%	Trajnimet kanë ndikim pozitiv
Mjaftueshëm të dobishme	44,8%	Ndihmë e kënaqshme për pjesën tjetër
Pak ose aspak të dobishme	3,5%	Pak ankesa për cilësinë
TEMAT E KËRKUARA PËR TRAJNIME TË ARDHSHE	-	Prioritetet kryesore të mësuesve:
- Metodat interaktive dhe digjitale	-	Përdorimi i teknologjisë në mësim
- Menaxhimi i klasave të përziera	-	Si të punojnë me nxënës të niveleve dhe moshave të ndryshme
- Plane mësimore fleksibël	-	Për orare të reduktuara (1–2 herë në javë)
- Ndërtimi i materialeve vetjake	-	Zhvillim i materialeve dhe punë me projekte
- Integrimi i kulturës shqiptare	-	Përmes artit, muzikës dhe letërsisë

SUGJERIMET E MËSUESVE PËR PËRMIRËSIM TË MËTEJSHËM

Në fund të pyetësorit, mësuesve u është lënë hapësirë e lirë për të shprehur komentet, sugjerimet dhe vërejtjet e tyre, duke dhënë kështu një pasqyrë të vlefshme cilësore mbi përvojën e tyre në mësimdhënie, si dhe mbi bashkëpunimin me QBD-në. Këto përgjigje përbëjnë një burim të rëndësishëm rekomandimesh të drejtpërdrejta nga praktika.

1. Nevoja për më shumë materiale të strukturuar sipas moshës dhe nivelit gjuhësor

Një numër i konsiderueshëm mësuesish theksojnë rëndësinë e përshtatjes së materialeve sipas nivelit të nxënësve dhe kontekstit të mësimdhënies. Kërkesat kryesore përfshijnë:

- Tekste të dedikuara për fillestarë, për fëmijë me prindër joshqiptarë dhe për nxënës me njohuri të pjesshme të gjuhës;
- Paketa të ndara sipas klasave ose sipas fushave të të nxënës (shkrim, lexim, të folur, dëgjim);
- Ushtrime të thjeshtuara dhe të përshtatura për orare të kufizuara (1–2 orë në javë).

2. Digjitalizimi dhe rritja e aksesit online

Shumë mësues theksojnë rëndësinë e aksesit të lehtë dhe të shpejtë në materialet mësimore në format digjital. Ata sugjerojnë:

- Publikimin online të të gjitha teksteve dhe materialeve ndihmëse në format PDF ose përmes platformave të dedikuara;
- Krijimin e një platforme të qëndrueshme digjitale për qasje, shkarkim dhe përdorim të burimeve të QBD-së;
- Shtimin e përmbajtjeve audiovizive, librave digjitalë dhe videove mësimore për të mbështetur mësimdhënien ndërvepruese.

3. Trajnime të rregullta dhe të aksesueshme për të gjithë

Sugjerimet e mësuesve për trajnime janë të shumta dhe të detajuara:

- Kërkohet zhvillimi i trajnimeve në formë online, të regjistrueshme, për të qenë të përshtatshme për oraret dhe kohëzonat e ndryshme;
- Mësuesit kërkojnë trajnim mbi përdorimin e teksteve në praktikë, jo vetëm teori metodologjike;
- Disa sugjerojnë takime periodike rajonale mes mësuesve të të njëjtit vend, për të shkëmbyer praktika dhe për të ndërtuar rrjete mbështetjeje.

4. Forcimi i komunikimit dhe ndjekjes nga QBD-ja

Mësuesit kërkojnë një marrëdhënie më të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme me QBD-në. Sipas tyre, nevojiten:

- Pikë kontakti të përhershme dhe aktive me QBD-në, për t'u informuar rregullisht mbi dërgesat, trajnimet dhe nismat e reja;
- Një komunikim më të shpejtë dhe funksional për pyetje ose probleme që lidhen me tekstet dhe dërgesat;
- Vlerësim të drejtpërdrejtë të kontributit të mësuesve, përmes ftesave në aktivitete, përfshirje në grupe pune ose certifikime vjetore.

5. Njohje dhe motivim për mësuesit e diasporës

Një shqetësim i përsëritur ka të bëjë me mungesën e njohjes formale të kontributit që japin mësuesit në diasporë. Disa sugjerime konkrete përfshijnë:

- Certifikata zyrtare të vlerësimit;
- Promovimi i praktikave të mira përmes botimeve, ekspozitave apo portaleve të posaçme;
- Mundësi për përfshirje në projekte kombëtare dhe vizita profesionale në Shqipëri.



Sugjerimet e mësuesve të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë janë të qarta, të strukturuar dhe realiste. Ato pasqyrojnë një gatishmëri të lartë për përmirësim, por edhe një kërkesë të drejtpërdrejtë për një mbështetje më të qëndrueshme nga ana e institucioneve shqiptare.

SI E SHOHIN MËSUESIT PUNËN E QENDRËS SË BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Të dhënat e mbledhura përmes kësaj ankete pasqyrojnë në mënyrë të qartë dhe të shumanshme vlerësimin dhe mënyrën si e shohin mësuesit shqiptarë në diasporë punën e Qendrës së Botimeve për Diasporën, si institucioni që siguron tekste mësimore dhe mbështetje për mësimin e gjuhës shqipe jashtë vendit.

Në përgjithësi, QBD-ja gëzon një vlerësim pozitiv, veçanërisht në aspektin e **sigurimit dhe shpërndarjes së teksteve mësimore**. **82.4%** e mësuesve deklarojnë se i përdorin rregullisht tekstet e dërguara nga QBD-ja dhe **86.3%** i konsiderojnë ato të përshtatshme ose shumë të përshtatshme për moshën dhe nivelin e nxënësve. Kjo tregon një pranim të gjerë dhe dobishmëri të lartë të këtyre materialeve në praktikën mësimore të përditshme në shkolla dhe kurse të ndryshme në diasporë.

Po ashtu, **materialët ndihmës**, si fjalorët dygjuhësh, librat me përralla apo tregime, janë vlerësuar për ndikimin që kanë në ndërtimin e fjalorit dhe lidhjen kulturore të nxënësve me atdheun. Edhe pse përdorimi i tyre është pak më i ulët (**68.3%**), ato konsiderohen të dobishme dhe mësuesit kanë sugjeruar që ato të jenë më të aksesueshme në formate digjitale dhe të organizohen sipas moshës apo nivelit.

Trajnimet e organizuara nga QBD-ja, për ata që kanë marrë pjesë, kanë marrë një vlerësim shumë të lartë për cilësinë e përmbajtjes dhe ndihmën praktike që kanë ofruar. **96.5%** e mësuesve që kanë ndjekur trajnime i kanë cilësuar si të dobishme ose mjaftueshëm të dobishme, duke theksuar nevojën për vazhdimësi dhe zgjerim të kësaj forme mbështetjeje profesionale.

Për më tepër, vetëm 36.5% kanë marrë pjesë në trajnimet e ofruara. **Vlen të theksohet** se QBD-ja në këto vite ka ofruar trajnime për mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Itali, Greqi dhe Zvicër, me një numër të kënaqshëm pjesëmarrësish. Këto trajnime janë pjesë e programit të punës së QBD-së me një shtrirje në të ardhmen edhe në vende të tjera.

Megjithatë, sfidat qëndrojnë në fushat e komunikimit institucional dhe aksesit të barabartë në shërbime. **45.5%** e mësuesve shprehen se ndihen të mbështetur nga QBD-ja, 30% ndihen të mbështetur pjesërisht, ndërsa 24.5% nuk ndihen të mbështetur.

Përsa i përket lehtësisë së komunikimit me Qendrën, **38.2%** e mësuesve e vlerësojnë atë si shumë të lehtë dhe 38.9% e llerësojnë të lehtë. Vetëm 1.6% e konsiderojnë komunikimin të vështirë, ndërsa 15.4% nuk kanë provuar të komunikojnë me QBD-në.

Në lidhje me përfshirjen nga QBD-ja kur bëhen sugjerime apo ankesa, **67.9%** e të anketuarve shprehen se ndihen të dëgjuar dhe të përfshirë, 23.4% ndihen pjesërisht të tillë, ndërsa vetëm 9.3% thonë se nuk ndihen të dëgjuar apo të përfshirë.

Sa i përket vlerësimit të situatës aktuale të mësimdhënies së gjuhës shqipe në diasporë, **45.5%** e të anketuarve e konsiderojnë atë “të mirë” dhe **18.5%** “shumë të mirë”. **26.4%** e vlerësojnë si “mesatare”, ndërsa **9.6%** e konsiderojnë “të dobët”. Këto të dhëna sugjerojnë një perceptim përgjithësisht pozitiv, megjithëse ka ende hapësira për përmirësim.

Të anketuarit identifikojnë disa nga vështirësitë kryesore në mësimdhënien e gjuhës shqipe në vendet ku jetojnë. Problematika më e theksuar është mosangazhimi i prindërve, i raportuar nga 69.3% e mësuesve. Mungesa e mbështetjes institucionale renditet e dyta me 46.1%, ndjekur nga mosinteresi i nxënësve me 27.5% dhe mungesa e teksteve të përshtatshme me 18.1%. Këto të dhëna nënvizojnë nevojën për përfshirje më të madhe të prindërve dhe forcim të mbështetjes institucionale.

Sa i përket fushave ku Qendra e Botimeve për Diasporën ka dhënë më shumë mbështetje, **85.9%** e të anketuarve theksojnë sigurimin e teksteve mësimore dhe materialeve ndihmëse si ndihmën më të dukshme. Aftësimi profesional i mësuesve përmendet nga 29.5%, krijimi i rrjetit të mësuesve nga 25.7%, ndërsa mbështetja morale dhe institucionale nga 21.2% e mësuesve. Vetëm 5.2% e të anketuarve shprehen se nuk kanë marrë ndihmë në asnjërën prej këtyre fushave.

Në lidhje me ndikimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën në mësimdhënien e gjuhës shqipe gjatë gjashtë viteve të fundit, 62.9% e të anketuarve mendojnë se situata ka ndryshuar për mirë. Ndërkohë, 15.3% mendojnë se ka pasur një ndryshim të pjesshëm, 4.9% nuk shohin ndonjë ndryshim, ndërsa 17.2% deklarojnë se nuk kanë informacion të mjaftueshëm për ta vlerësuar.



Gjetjet e kësaj ankete tregojnë se QBD-ja ka ndërtuar një themel të fortë për mbështetjen e mësuesve të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë, por që kërkon bashkëpunim të strukturave mbështetëse, sidomos për sa i përket komunikimit të drejtpërdrejtë me mësuesit, ofrimit të burimeve online dhe trajnimeve të rregullta.





Tabela e mëposhtme paraqet përqindjet kryesore sipas tematikës së anketës:

Kategoria e pyetjeve	Përqindja	Shënime
Përdorimi i teksteve të QBD-së	82,4%	Përdorim i rregullt i teksteve në mësimdhënie
Përshtatshmëria e teksteve për moshën/nivelin	86,3%	Vlerësim pozitiv për përshtatshmërinë e teksteve
Përdorimi i materialeve ndihmëse	68,3%	Përfshirja e materialeve ndihmëse gjatë procesit të mësimdhënies
Mbështetja nga QBD-ja	75,5%	Mësuesit ndihen të mbështetur (plotësisht dhe pjesërisht)
Pjesëmarrja në trajnime	36,5%	Mësuesit që kanë marrë pjesë në trajnime
Vlerësimi i dobisë së trajnimeve	96,5%	Trajnimet vlerësohen si shumë të dobishme/mjaftueshëm
Vlerësimi i shpërndarjes së teksteve	60,0%	Mësuesit e vlerësojnë me efikasitet shpërndarjen e teksteve
Ndihen të dëgjuar dhe të përfshirë nga QBD-ja	91,3%	Përfshirja e mësuesve në proceset e QBD-së (sugjerime, ankesa)
Lehtësia e komunikimit me QBD-në	77,1%	Kjo është përqindja e mësuesve që e vlerësojnë komunikimin si të lehtë ose shumë të lehtë
Ndikimi i QBD-së në klimën e mësimdhënies në diasporë gjatë 6 viteve të veprimtarisë së saj	78,2%	Ndikimi (i plotë dhe i pjesshëm) gjatë periudhës 2019–2025
Fusha ku QBD-ja ka ndihmuar më shumë (tekste mësimore dhe ndihmëse)	85,9%	Sigurimi i materialeve si mbështetja kryesore për mësimin e gjuhës shqipe
Vlerësimi i situatës aktuale të mësimdhënies së gjuhës shqipe në diasporë	64% (45,5% “e mirë”, 18,5% “shumë të mirë”)	Perceptim pozitiv për gjendjen e mësimdhënies në përgjithësi
Sfidat kryesore në mësimdhënie	69,3% (mosangazhimi i prindërve)	Problemet kryesore të identifikuara nga mësuesit
	46,1% (mungesa e mbështetjes institucionale)	



Grafiku më poshtë paraqet përmbledhtas vlerësimin dhe mënyrën si e shohin mësuesit shqiptarë në diasporë punën e Qendrën e Botimeve për Diasporën.



Vlerësimi i përgjithshëm për Qendrën e Botimeve për Diasporën, bazuar në treguesit kryesorë të përgjigjeve të anketimit është 81.6%.



Vlerësimi i përgjithshëm për Qendrën e Botimeve për Diasporën është 81.6%, duke reflektuar një ndikim pozitiv dhe nivel të lartë vlerësimi për tekstet mësimore, ndihmëse dhe trajnimet, por edhe nevojën për të përmirësuar aksesin, komunikimin dhe ndërveprimin me mësuesit në mënyrë gjithëpërfshirëse.

VËSHTRIM CILËSOR: ZËRI I MËSUESVE NË DIASPORË

Përveç analizës sasiore, një vlerë të veçantë i jep këtij relacioni edhe dimensionin cilësor i përgjigjeve, i cili pasqyrohet në komentet e hapura të lëna nga mësuesit në fund të pyetësorit. Këto komente, të dhëna në mënyrë të sigurtë dhe spontane, ofrojnë perspektivën njerëzore dhe të drejtpërdrejtë të përvojës së tyre në terren.

Fjalët e mësuesve sjellin në mënyrë autentike sfidat, mirënjohjen, si dhe shpresën për një mbështetje më të qëndrueshme nga institucionet shqiptare. Më poshtë janë disa prej citimeve më përfaqësuese, të cilat përforcojnë gjetjet e analizës sasiore:

“Tekstet e QBD-së më ndihmojnë shumë në ndërtimin e strukturës së mësimit, por nxënësit kanë nevojë për më shumë ilustrime dhe ushtrime që lidhen me realitetin ku jetojnë.” - Mësuese, Itali

“Kam marrë pjesë në një trajnim online dhe ishte shumë frytdhënëse. Do të dëshiroja që të kishte më shpesh dhe të ishin të regjistruar për ta ndjekur edhe më vonë.” - Mësues, Kanada

“Shpërndarja e teksteve këtë vit ishte me vonesë. Kjo më detyroi të improvizoj për disa javë. Do të ishte ndihmesë e madhe një sistem më i qëndrueshëm porositjeje.” - Mësuese, Gjermani

“Ne kemi dëshirë të punojmë dhe ta mbajmë gjallë shqipen, por na duhet ndihmë më e organizuar – materiale online, fletore pune, libra leximi për fundjavë.” - Mësuese, Suedi

“Materialet e QBD-së janë të mirëpritura, por kemi nevojë për versione digjitale që mund t'i shpërndajmë më lehtë tek prindërit dhe nxënësit.” - Mësuese, Zvicër

Këto komente përfaqësojnë jo vetëm vëzhgime konkrete për aspekte teknike apo përmbajtjesore, por edhe emocionin, përkushtimin dhe sfidat reale me të cilat përballen mësuesit shqiptarë në diasporë çdo javë. Zëri i tyre duhet të shërbejë si udhërrëfyes për vendimmarrjen institucionale, në mënyrë që politikat e mbështetjes të bazohen jo vetëm në të dhëna, por edhe në përvojën e drejtpërdrejtë të atyre që janë në frontin e ruajtjes së gjuhës e kulturës shqiptare jashtë atdheut.

PËRFUNDIME

Ky relacion analitik paraqet një pasqyrë të qartë dhe të gjithanshme të përvojës, mendimeve dhe nevojave të mësuesve të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë, ashtu siç u shprehën përmes anketës së realizuar në muajin prill 2025. Ai është hartuar në kuadër të zbatimit të objektivave të përcaktuara në *“Planin e Integritetit të Qendrës së Botimeve për Diasporën”*, miratuar me shkresën nr. 74/6 prot., datë 25.09.2023, dhe fokusohet në evidentimin e situatës aktuale të mësimdhënies në diasporë, si dhe në identifikimin e sfidave dhe nevojave reale të mësuesve.

Rezultatet e anketës tregojnë një nivel të lartë të përkushtimit profesional të mësuesve, si dhe një besim të qëndrueshëm ndaj rolit të QBD-së si institucion përgjegjës për mbështetjen didaktike dhe kulturore. Tekstet mësimore dhe materialet ndihmëse të QBD-së vlerësohen pozitivisht dhe përdoren gjerësisht, duke përbërë bazën e procesit mësimor në shumë vende ku zhvillohet mësim në gjuhën shqipe.

Nga ana tjetër, analiza nxjerr në pah edhe aspekte ku mbështetja institucionale ka nevojë të thellohet, veçanërisht në drejtim të shpërndarjes në kohë të materialeve, trajnimeve të rregullta, komunikimit të drejtpërdrejtë me mësuesit dhe digjitalizimit të burimeve.

Ky relacion nuk ka vetëm qëllim pasqyrimin e statistikave, por mbi të gjitha ngre zërin e mësuesve shqiptarë jashtë atdheut, që me profesionalizëm dhe pasion kontribuojnë në ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe identitetit kombëtar.

Të dhënat dhe komentet e mbledhura këtu përbëjnë një bazë të vlefshme për mbështetje më të qëndrueshme dhe dialog më të drejtpërdrejtë mes institucioneve dhe komuniteteve të mësuesve në diasporë.

Ky dokument synon të shërbejë si një instrument reflektimi dhe veprimi për QBD-në dhe të gjitha strukturat përgjegjëse për arsimin e shqiptarëve jashtë kufijve shtetërorë. Në të njëjtën kohë, ai është një dëshmi e përbashkët e angazhimit për ruajtjen dhe përçimin e gjuhës shqipe brez pas brezi.

QBD-ja do të shqyrtojë me prioritet këto gjetje për të hartuar një plan konkret veprimi në vijim.

www.qbd.gov.al
info@qbd.gov.al